

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality ~~Rahovec~~
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – ~~Municipal Rahovec~~



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/277 Nr. i faq/Br.str/No.pg 72

Data/Datum/Date 28 / 12 / 2024

PLANI I PUNËS
I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN
2025



DHJETOR - 2024

Pasqyra e planit 2025

Parathënie.....

Janar.....

Shkurt.....

Mars.....

Prill.....

Maj.....

Qershor.....

Korrik.....

Gusht.....

Shtator.....

Tetor.....

Nëntor.....

Dhjetor.....

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe të planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe të ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, të dekoratave dhe të titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, të rrugicave dhe të vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, të dokumenteve fiskale dhe financiare, të planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që, përmes formave të ndryshme, të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj, përfshirë edhe funksione të tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara, si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;

- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Planit Zhvillimor Urban (PZHU), dhe Planet Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre, dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet e tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe të detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet e tjera nënligjore.

Me këtë plan, synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku Kuvendi i Komunës së

Rahovecit planifikon t'i mbajë maksimum 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmuajorin e parë dhe 6 (gjashtë) në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Rahovecit, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo të Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit.

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe të lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2025, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë të mbahen 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca të tjera, përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne, siç parashihet, me LVL-në dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe të agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2025.

Plani i Punës së Kuvendit, sipas dinamikës mujore, përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2025, do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

01 Nr. 277/24
Rahovec, 26.12.2024

Kryesuesi i Kuvendit

Arbër Zenuni



Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025

		Rend Dite		Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
JANAR		1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	10.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
		2	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Kuvendi/ekzekutiv	10.02.2025	Ekzekutivi/KK	
		3	Shqyrtimi i Raportit për realizim e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024	Zyra e Kuvendit	10.02.2025	KPF/KK	
		4	Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar 2024	Drejtori për Buxhet dhe Financa	10.02.2025	KPF/KK	
		5	Shqyrtimi i implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2024	Ekzekutivi	10.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
		6	Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024	Kryetari i Këshillit	10.02.2025	Kuvendi	
		7	Shqyrtimi i Raportit rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2024	Kryetari i Komunës	10.02.2025	Kuvendi	
		8	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024	Kryesuesi i K. Komunitete	10.02.2025	Kuvendi	
		9	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2024	Kryesuesi i K. Për Shëndetësi	10.02.2025	Kuvendi	
		10	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2024	Kryesuesi i K. P.AK	10.02.2025	Kuvendi	
		11	Shqyrtimi i raportit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	Kryetari komisionit	10.02.2025	Kuvendi	Kuvendi
		12	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	10.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
		13	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	10.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
SHKURT		Rend Dite		Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
		1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	07.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
		2	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve	Kuvendi/ekzekutivi	07.02.2025	Ekzekutivi/KK	
		3	Bartja (rialokim) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	D. Financa	07.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
		4	Informatë rreth Planit për Banim Social 3-vjeçar	Ekzekutivi	07.02.2025	Kuvendi	
		5	Informatë rreth përfundimit të gjysmëvjetorit të parë arsimor	D. Arsimit	07.02.2025	Kuvendi	Kuvendi
		6	Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit	Ekzekutivi	07.02.2025	Kuvendi	
		7	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	07.02.2025	KPF/KK	Kuvendi
8	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	07.02.2025	KPF/KK	Kuvendi		

		Rend Dite				Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
MARS	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar				Zyra e Kuvendit	07.03.2025	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve				Kuvendi/Ekzekutivi	07.03.2025	Ekzekutivi/KK	
	3	Raport mbi menaxhimin e asetëve komunale (inventari) për vitin 2024				Ekzekutivi	07.03.2025	Kuvendi	
	4	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre				Ekzekutivi	07.03.2025	Kuvendi	
	5	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal				Ekzekutivi/Kuvendi	07.03.2025	KPF/KK	Kuvendi
	6	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit				Ekzekutivi/Kuvendi	07.03.2025	KPF/KK	Kuvendi
PRILL	Rend dite								
	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar				Zyra e Kuvendit	04.04.2025	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve				Kuvendi/Ekzekutivi	04.04.2025	Ekzekutivi/KK	
	3	Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar janar - mars 2025				D. e Financave dhe e Buxhetit	04.04.2025	KPF/Kuvendi	
	4	Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror				D. e Shërbimeve Publike	04.04.2025	Kuvendi	
	5	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal				Ekzekutivi/Kuvendi	04.04.2025	KPF/KK	Kuvendi
6	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit				Ekzekutivi/Kuvendi	04.04.2025	KPF/KK	Kuvendi	
MAJ	Rend Dite								
	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar				Zyra e Kuvendit	05.05.2025	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve				Kuvendi/Ekzekutivi	05.05.2025	Ekzekutivi/KK	
	3	Informatë mbi Qarkoren 1-rë të MF-së				D. e Financave dhe e Buxhetit	05.05.2025	KPF/KK	
	4	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal				Ekzekutivi/Kuvendi	05.05.2025	KPF/KK	Kuvendi
5	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit				Ekzekutivi/Kuvendi	05.05.2025	KPF/KK	Kuvendi	

	Rend Dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrtton	Miraton	
QESHOR	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	06.06.2025	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendit	06.06.2025	Ekzekutivi/KK	
	3	Miratimi i Kormizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028	D. e Financave dhe e Buxhetit	06.06.2025	KPF/KK	Kuvendi
	4	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2025	D. e Financave dhe e Buxhetit	06.06.2025	KPF/KK	Kuvendi
	5	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025	Ekzekutivi i komunës	06.06.2025	KPF/KK	
	6	Raporti i performancës komunale për vitin 2024	Koordinatorë për performancë	06.06.2025	Kuvendi	
	7	Raporti i punës së KKSBB-së për 6 mujorin 2025	Kryetari	06.06.2025	Kuvendi	
	8	Informata mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit	D. e Shërbimeve Publike	06.06.2025	Kuvendi	
	9	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	06.06.2025	KPF/KK	Kuvendi
	10	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	06.06.2025	KPF/KK	Kuvendi
KORRIK		Rend Dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrtton	Miraton
	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kalar	Zyra e Kuvendit	04.07.2025	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	04.07.2025	Ekzekutivi/Kuvendi	
	3	Informata për Qarkoren e 2-të buxhetore	D. Financa dhe Buxhet	04.07.2025	KPF/KK	
	4	Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2025	D. e Financave dhe e Buxhetit	04.07.2025	KPF/KK	
	5	Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2024/2025	D. e Arsimit	04.07.2025	Kuvendi	
	6	Informata nga Drejtoria e Bujqësisë – Mbetet edhe për vitin 2025	D. e Bujqësisë	04.07.2025	Kuvendi	
	7	Informata nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	D. e Shërbimeve Publike	04.07.2025	Kuvendi	
	8	Shqyrtimi i Raportit të ZAP-it për vitin 2024 dhe Plani i Veprimt (Para datës 30 shtator)	Ekzekutivi	04.07.2025	KPF/KK	
	9	Informata mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit	D. e Shërbimeve Publike	04.07.2025	Kuvendi	
10	Informata mbi realizimin e planit të punës së Zyrës së Prokurimit janar – qershor 2025	Zyra e Prokurimit	04.07.2025	Ekzekutivi/Kuvendi	Kuvendi	
11	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	04.07.2025	Ekzekutivi/Kuvendi	Kuvendi	

12	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit		Ekzekutivi/Kuvendi	04.07.2025	KPF/KK	Kuvendi
	Rend Dite		Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Zyra e Kuvendit	06.08.2025	KPF/KK	Kuvendi
2	Pyejet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	06.08.2025	Ekzekutivi/Kuvendit	
3	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në	D. e Shërbimeve Publike	D. e Shërbimeve Publike	06.08.2025	Kuvendi	
4	Informatë mbi Hapësirat e Hapura Publike në komunën e Rahovecit	D. e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike	D. e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike	06.08.2025	Kuvendi	
5	Informatë mbi implementimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Rahovecit	D. e Shërbimeve Publike	D. e Shërbimeve Publike	06.08.2025	Kuvendi	
6	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	06.08.2025	Ekzekutivi/Kuvendit	Kuvendi
7	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	06.08.2025	Ekzekutivi/Kuvendit	Kuvendi
8	Vizitë studimore me kuvendarë jashtë territorit të Republikës së Kosovës	Kryesuesi/Financat	Kryesuesi/Financat	06.08.2025	Ekzekutivi/Kuvendit	Kuvendi
	Rend Dite		Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Zyra e Kuvendit	05.09.2025	KPF/KK	Kuvendi
2	Pyejet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	05.09.2025	Ekzekutivi/Kuvendit	
3	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2026	D. e Buxhetit dhe e Financave	D. e Buxhetit dhe e Financave	05.09.2025	KPF/KK	Kuvendi
4	Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore	D. e Arsimit	D. e Arsimit	05.09.2025	Kuvendi	Kuvendi
5	Informatë për përgatitjen e viti shkollor 2025/2026	D. e Kulturës	D. e Kulturës	05.09.2025	Kuvendi	Kuvendi
6	Informatë rreth muajit të mërgimtarëve për vitin 2025	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	05.09.2025	KPF/KK	Kuvendi
7	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	05.09.2025	KPF/KK	Kuvendi
8	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	05.09.2025	KPF/KK	Kuvendi

GUSHT

SHTATOR

	Rend Dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
TETOR	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	KPF/KK	Kuvendi
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	Ekzekutivi/Kuvendi	
	3	Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar – shtator 2025	D. e Financave dhe Buxhetit	KPF/KK	
	4	Shqyrtimi i Planit për menaxhim të mbeturinave	D. Shërbimeve publike	KPF/KK	
	5	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	6	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
NETOR		Rend Dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton
	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	05.011.2025	KPF/KK
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	05.11.2025	Ekzekutivi/KK
	3	Raport për punën e bujqve të komunës së Rahovecit	D. e Bujqësisë	05.11.2025	Kuvendi
	4	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	05.11.2025	KPF/KK
	5	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	05.11.2025	KPF/KK
DHJETOR		Rend Dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton
	1	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	05.12.2024	KPF/KK
	2	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Ekzekutivi/Kuvendi	05.12.2024	Ekzekutivi/Kuvendit
	3	Raport mbi realizimin e Planit për vitin 2025 si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2026	Zyra e Prokurimit	05.12.2024	Kuvendi
	4	Shqyrtimi i Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2025	Zyra e Kryetarit	05.12.2024	KPF/KK
	5	Informatë mbi Planin e punës të kryetarit të komunës për vitin 2026	Zyra e Kryetarit	05.12.2024	KPF/KK
	6	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2026	Zyra e Kuvendit	05.12.2024	KPF/KK
	7	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026	Kryetari i Komunës	05.12.2024	KPF/Kuvendi
	8	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi/Kuvendi	05.12.2024	KPF/KK
9	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi/Kuvendi	05.12.2024	KPF/KK	